



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 10

Prishtinë, më 02.05.2013, në orën 09:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Sasha Milosavleviq, Blerta Deliu - Kodra, Ismet Beqiri, Alma Lama, Suzan Novobërdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Xhavit Haliti, Fatmir Limaj, Vjosa Osmani dhe Blerim Shala.

Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri, Adelina Demolli dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi: Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-193 për Avokatinë, me amendamentet e komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-193 për Avokatinë, me amendamentet e komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetari – referues i projektligjit, paraqiti raportin për këtë projektligj. Projektligji për Avokatinë rregullon kushtet për ushtrimin e Avokatisë, mënyrat dhe format e punës, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e avokatëve dhe praktikantëve, organizimin dhe punën e Odës së Avokatëve të Kosovës dhe çështje të tjera që ndërlidhen me profesionin e avokatisë. Ky Projektligj përmban 74 nene dhe 16 amendamente.

Pas shqyrtimit, konstatoam se ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

Përfundim

Projektligji Nr. 04/L-193 për Avokatinë, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, është në harmoni me Acquis e BE-së.

Mbledhja përfundoi në orën 09:40.

E përgatiti:

Kryetari i Komisionit

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Lutfi HAZIRI